



# Panairi i të rinjve: rrugët e zhvillimit të karrierës në sektorin e turizmit

Fundjavën që shkoi, në Shkodër u organizua “Panairi i të rinjve: Rrugët e zhvillimit të karrierës në sektorin e turizmit”, i cili mbledhi së bashku nxënës nga Shkolla e Mesme e Kombinuar “Vëllazërim-Bashkim” në Ulqin dhe Shkolla Profesionale “Hamdi Bushati” në Shkodër. Panairi synoi të sjellë bashkë të rinjtë dhe punëdhënësit nga rajoni ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri, duke krijuar kështu mundësi për bashkëbisedim dhe hapësira të reja për aftësimin dhe punësimin e të rinjve në sektorin e turizmit.

Aktiviteti u organizua në një format miqësor ku të rinjtë nga Ulqini dhe Shkodra patën mundësi të krijojnë kontakte dhe shkëmbejnë eksperiencë me njëri tjetrin, të shpalosin aftësitë e tyre krijuese, të prezantojnë potencialet turistike të rajonit ndërkufitar përmes katalogëve dhe broshurave si dhe të promovojnë specialitetet e kuzhinave tradicionale

të të dy qyteteve. Të rinjtë po ashtu patën mundësi të komunikojnë me biznese të ndryshme për të eksploruar mundësitë e angazhimit gjatë stinës së verës.

Të rinjtë nga Ulqini, së bashku me mësime të tyre, u prezantuan në këtë panair me udhëzuesin turistik të titulluar “Për fundjavë në Ulqin”, i cili ofron një informacion të ilustruar për pikat më interesante që duhet të vizitohen, duke filluar nga pika kufitare në Sukubinë e deri në Limanin e Ulqinit.

Vlerësimet që shoqata Horizonti i Ri ka nxjerrë nga puna me të rinjtë përmes sesioneve trajnuese dhe aktiviteteve tjera, tregojnë se ata kanë një qëndrim pozitiv dhe optimist për tu angazhuar në sektorin e turizmit, fillimisht përmes punës praktike gjatë stinës së verës e më pas duke krijuar edhe idetë e veta të biznesit, të cilat do të mbështeten nga projekti që po

zhvillohet në të dy anët e kufirit. Në të njëjtën kohë, kjo shoqatë ka zhvilluar edhe një hulumtim në terren, sipas të cilit rezultoi se edhe punëdhënësit lokal janë të gatshëm t’iu sigurojnë të rinjve mundësi që të angazhohen në bizneset e tyre, të fitojnë shkathtësi të reja pune e pse jo edhe të punësohen në një periudhë më të gjatë.

Panairi i punës për të rinjtë u realizua në kuadër të projektit “Rrugët e zhvillimit të karrierës: Përgatitja e të rinjve nga Shqipëria dhe Mali i Zi për mundësi karriere në sektorin e turizmit”, financuar nga Bashkimi Evropian përmes programit ndërkufitar IPA II, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave dhe Mirëqenies Sociale e Malit të Zi (CFCU). Projekti zbatohet nga organizata World Vision Albania në partneritet me OJQ Horizonti i Ri, si dhe shkollat e mesme “Vëllazërim-Bashkim” nga Ulqini dhe “Hamdi Bushati” nga Shkodra.